KËRKESË
Nr.3469, datë 4.6.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë.22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugot (Rruga Hyrëse Berat)

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që vlerësimi i pasurisë tokë, është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.03.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", ndërsa i objekteve në bazë të vendimit nr.138, datë 23.03.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik. Pronari për të cilin është bërë shënimi "proces legalizimi" , do të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të ketë regjistruar objektin përkatës pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është prej 4 150 483 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRESE BERAT

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas	Tokë Truall			Objekt	Vlera	
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip	Çmimi	Vlera	Vlera lekë	Totale Lekë	Shënime
1	Shefit		Kasapi	8501	2/99	180	3100	558000		558000	Konfirmuar nga ZRPP
2	Jemin		Toto	8501	2/120	74	3100	229400		229400	Konfirmuar nga ZRPP
3	Jemin		Toto	8501	2/121	32	3100	99200		99200	Konfirmuar nga ZRPP
4	Sulejman		Toto	8501	2/123	40	3100	124000		124000	Konfirmuar nga ZRPP
5	Xhevair	Isuf	Gega	8501	2/128	155	3100	480500		480500	Konfirmuar nga ZRPP
6	Safet		Tomorri	8501	2/142	235	3100	728500	318883	1047383	Konfirmuar nga ZRPP; Objekti ne "Proces Legalizimi"
7	Vasil		Papa	8501	6/74	17	3100	52700		52700	Konfirmuar nga ZRPP
8	Vasil		Papa	8501	6/75	14	3100	43400		43400	Konfirmuar nga ZRPP
9	Sadush		Skrevani	8501	6/73	133	3100	412300		412300	Konfirmuar nga ZRPP
10	Blerim		Daji	8501	6/86	62	3100	192200		192200	Konfirmuar nga ZRPP
11	Resul		(Eskiu) Gusho	8501	6/85	200	3100	620000		620000	Konfirmuar nga ZRPP
12	Dashnor		Xhamari	8501	6/78	20	3100	62000		62000	Konfirmuar nga ZRPP
13	Lufti		Kabilo	8501	6/20	37	3100	114700		114700	Konfirmuar nga ZRPP
14	Fatmir		Hoxha	8501	7/234	29	3100	89900		89900	Konfirmuar nga ZRPP
15	Besnik		Bardhi	8501	3/90	5	3100	15500		15500	Konfirmuar nga ZRPP
16	Kujtim		Jaho	8501	3/92	3	3100	9300		9300	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				1236		3831600	318883	4150483	